



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.1020/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Hajriz Hoti, e me procesmbajtësen Kaltrina Çitaku, në konfliktin administrativ të paditësit, Rr.M. nga fshati G., Komuna e P., të cilin me autorizim e përfaqëson B.Xh., avokat nga P., kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani ta paditësit dhe të autorizuarit të tij, e në mungesë të paditurës, me dt.07.08.2018, merr këtë,

### A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, Rr.M. nga fshati G., Komuna e P., anulohet vendimi i të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me nr.5095692, i dt.04.05.2017 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

### A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në prani të paditësit dhe interpretit të gjuhës së shenjëve, S.N., në mungesë të të paditurës, të thirrur në mënyrë të rregullt.

I autorizuari i paditësit, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës padisë të dorëzuar në këtë Gjykatë me datën;19.06.2017, me të cilën ka kërkuar që të anulohet në tërësi vendimi i datës;04.05.2017 i marr nga e paditura si dhe të obligohet e paditura që ta trajtoj paditësin si shfrytëzues i të drejtës në pension me paaftësi të perhershme dhe t'ia paguaj pensionin per periudhen e kaluar duke filluar nga data;01.01.2017 deri në permbushjen përfundimtare bashkë me kamatën ligjore me normën 8% vjetore, për shkak se vendimi i atakuar me këte padi është vendim absolutisht i pabazuar dhe i kundërligjshëm. Është i kundërligjshëm sepse është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatësisht me Ligjin Nr. 04/L-131, Ligji per Skema Pensionale, përkatësisht neni 9 paragrafi 5 i këtij ligji si dhe neni 21 të të njëjtit ligj, ku flitet për “nderprerjen e pageses se pensioneve” ku janë të parapara në mënyrë decisive ne paragrafin 1.1, 1.2, 1.3 të këtij neni arsyet se në cilat raste do të bëhet nderprerja e pageses se pensioneve. Ndërsa në rastin tonë konkret askund nuk është e precizuar të thuhet në ligje se “Nuk ka dokumentacion mjekësor të mjaftueshem për të qenë perfitues i pensionit me paaftësi të perhershme”, që do të thotë se kjo arsye është në kundërshtim me dispozitat ligjore. Po ashtu për ta plotësuar këtë që po themi vendimi i atakuar i të paditurës është në kundërshtim edhe me dispozitat e Udhëzimit Administrativ numer 05/2015 për Procedurat e Lajmërimit për Suspendimin nga Pagesa dhe Kthimin e mjeteve ne rastin e keqperdorimit te pensioneve, për shkak se edhe në këtë udhëzim në nenin 6 të tij flitet për ndërprerjen e pageses së pensionit përkatësisht për arsyen e ndërprerjes. Mirëpo asnjeri paragraf i këtij neni nuk e parasheh që ti ndërprehet pensioni ndonjë

shfrytëzuesi për shkak se nuk ka dokumentacion mjekesor të mjaftueshem, por arsyet e nderprerjes jane: kur pensionisti vdes, kur pensionisti ka bërë mashtrim gjatë procesit të aplikimit ose gjatë monitorimit, kur pensionisti e ka bartë autorizimin për terheqjen e pensionit të personi tjetër. Ndërsa në rastin tonë nuk ekziston asnjëri nga këto kushte që nënkupton se e paditura në mënyrë të kundërligjshme i'a ka ndërprerë të drejten e tij për shfrytëzimin e pensionit me paaftesi të perhershme. Prandaj duke u bazuar në këtë i ka propozuar Gjykatës që ta ndryshoj vendimin e kontestuar të të paditurës dhe të detyrohet e paditura që ta trajtojë paditësin si shfrytëzues i të drejtës në pension me paaftesi të perhershme dhe të i'a paguaj pensionin për periudhën e kaluar duke filluar nga data;01.01.2017, deri në përmbushjen përfundimtare bashkë me kamatën ligjore me normën 8% vjetore, si dhe shpenzimet e procedurës.

E autorizuar e të paditurës, Avokatura Shtetërore, me parashtresën e dt.07.08.2018 ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi të dt.23.04.2018 dhe i ka propozuar Gjykatës që pas administrimit të provave, ta refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar, ndërsa vendimin e kontestuar, t'a lenë në fuqi, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.07.08.2018, ka bërë administrimin e provave dhe atë, vendimi i te paditurës të dt.04.05.2017, dt.25.06.2014, fletëlëshimi i QKUK nr.2163, vërtetimi i lëshuar nga Klinika Nefrologjisë e dt.15.03.2017, fletëleshimi nga i Spitalit F. i D. dt.06.04.2009, dt.07.05.2009 dhe dt.21.02.2017, përgjigjen ne padi të dt.21.04.2018, vendimin dt.04.04.2011, dt.15.06.2010 dhe dt.24.02.2017, ankesa dt.27.03.2017, fletëlëshimi nr.1109 vlerësimi i komisionit mjekësor i dt.28.03.2011, dt.16.06.2014, dt.17.02.2017 dhe dt.21.04.2017, raporti i çëndrës dignostike dhe terapeotike E. M.-B e dt.07.02.2017, raporti i Emergjencës në Prishtinë të dt.14.06.2014, certifikata e mjekut dt.12.01.2010, kërkesa e paditësit dt.13.01.2010, raportet e QKUK dt.15.02.2004, dt.15.03.2011 dhe dt.10.03.2011, fletëlëshimi nr.2506 dhe nr.4072 të QKUK-se, konstatimi radiologjik i dt.05.02.2009, raporti mjekësor i Shërbimit Ambulator i dt.26.06.2007, si dhe parashtresa e të paditurës e dt.07.08.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Me vendimin e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, me nr.5095692, i dt.04.05.2017, është refuzuar ankesa e paditësit Rr.M. e dt.27.03.2017 për njohjen e të drejtës në pension për personat me paaftesi të perhershme.

Paditësi e pakënaqur me këtë vendim, me datë;19.06.2017, ushtron padi në gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e tij.

Nga vendimi i kontestuar rrjedhë se ai përmban të meta të tilla për shkak të te cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkëljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031. Shkëljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 të këtij ligji është paraparë se “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.2. Një arsyetim që është dukshëm i

pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar.

Në arsyetimin e vendimit të organit të shkallës së dytë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se “Këshilli i ankesave si organ i shkallës së dytë me ekspert mjekësor të lëmive përkatëse duke vepruar sipas ankesës të z/znj Rr.M. ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës në seancën e dt.21.04.2017, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor që gjendet në lëndë dhe vlerësimet e komisionit të shkallës së parë, në përputhje me paragrafin 5 të nenit 9 të PAK, dhe ka konstatuar-vlerësuar se nuk ka dokumentacion mjekësor të mjaftueshëm për të qenë përfitues i pensionit për persona me pa aftësi të përhershme, prandaj komisioni mjekësor i shkallës së dytë pajtohet me vlerësimin e komisionit të shkallës së parë që nuk janë plotësuar kriteret e parapara me ligj”

Më provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe atë me vendimin e të paditurës dt.15.06.2010, gjykata vëren se paditësit i është miratuar kërkesa për pension të Personave me Aftësi të Kufizuar nga dt.13.01.2010, në periudhën kohore prej një (1) viti.

Po ashtu edhe me vendimin e të paditurës dt.04.04.2011, gjykata vëren se paditësit i është vazhduar e drejta në pension të Personave me Aftësi të Kufizuar nga dt.13.01.2011, në periudhën kohore prej tre (3) vitesh.

Gjithashtu edhe me vendimin e të paditurës dt.27.06.2014, gjykata vëren se paditësit rapë i është vazhduar e drejta në pension të Personave me Aftësi të Kufizuar nga dt.05.01.2014, në periudhën kohore prej tre (3) vitesh.

Ndërsa me vendimin e të paditurës të dt.24.02.2017, gjykata gjene se paditësit i është ndërprerë e drejta në pension të personave me paaftësi të përhershme, me konstatim se arsye e ndërprerjes se pensionit është “Pas rishqyrtimit dhe rivlerësimit të komisionit mjekësor të datës;14.02.2017 u vërtetua se gjendja shëndetësore në krahasim me gjendjen e mëparshme është përmirësuar”.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur, nuk ka bërë fare arsyetim në vendimin e saj, se nga cila bazë paditësit i është përmirësuar gjendja shëndetësore, kur me vendimin e dt.24.02.2017 ju ka ndërprerë e drejta në pension, kurse nga vlerësimi i Komisionit Mjekësor i dt.17.02.2017 dhe të dt.21.04.2017, nuk shihet se si ka ardhur deri në këtë përfundim, pasi që paditësi këtë të drejtë e ka shfrytëzuar nga dt.13.01.2010 deri me dt. 24.02.2017, ku për këtë periudhë kohore i njëjti i ka plotësuar kushtet për të qenë përfitues i pensionit për personat me paaftësi të përhershme.

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej tridhjetë (30) ditësh në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t’i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të, Ligjit për Konfliktet Administrative ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
A.nr.1020/2017, dt.07.08.2018,

Procesmbajtëse  
Kaltrina Çitaku

G j y q t a r  
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.